



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, miratoi këtë

V E N D I M

Neni 1

Miratohet vendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e Pallatit të Rinisë në ndërmarrje publike lokale.

Neni 2

Autorizohet Kryetari i Komunës që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë iniciimin e procedurave të negociimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës, për kthimin e Pallatit të Rinisë në ndërmarrje publike lokale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.nr.031-124248, më 23.05.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.